

## **Edukimi shëndetësor ,qershor 2014**

Qendra e shëndetit publik Shkup sipas planit tremujor për punën në repartin për edukim shëndetësor vazhdon me edukimin shëndetësor për popullatën në zonën e saj.

Në muajin qershor në Qendrën e shëndetit publik Shkup në repartin e mjekësisë sociale është hapur dhe ka filluar me punë këshillimorja për dorëheqje nga pirja e duhanit.

Për atë qëllim sipas përfundimeve të komitetit për shëndet dhe mjedis jetësor pranë Ministrisë së shëndetësisë, aktivitetet filluan me edukimin e të punësuarve,punëtorët shëndetësor dhe bashkëpunëtorët.



Në këshillimoren për dorëheqje nga pirja e duhanit, ligjëratat edukative mbahen çdo ditë prej orës 13 deri në orën 15.

Qëllimi i edukimit të lartpërmendur është që ti njoftojnë të punësuarit për punën e këshillimores për dorëheqje nga pirja e duhanit.

Edukimi i përfshin përmbajtjet në vijim;

- Metoda të punës me qëllim të përcaktohet modeli i trajnimit të përdoruesit, përkatësisht të varurit nga duhani.
- Edukimi grupor apo individual – këshillimi
- Procesi në vijim për dorëheqje nga pirja e duhanit përdoret 5A strategji test fagenstrom test për vlerësimin e vashërisë të duhanit test ROSS.

- Të dhënat për pirjen e duhanit në botë dhe tek ne.
- Përfitimet nga jo pirja e duhanit
- Efektet e dëmshme shëndetësore të pirjes së duhanit
- Procesi i ndryshimit të sjelljes
- Qëllimi përfundimtar i përdoruesit – dorëheqja nga duhani.



Qendra e shëndetit publik Shkup, qershor 2014

Në muajin qershor 2014 edukimi shëndetësor në zonën e Shkupit ishin të përfshirë edhe personat e moshuar. Për atë qëllimi ishin të vizituar Institucioni privat për mbrojtjen sociale të të moshuarve „ Zhana,, në komunën e Butelit. Gjatë vizitës ishin të mbajtura 2 ligjërata për 29 persona të moshuar me temat në vijim:

- Përmirësimi i shëndetit te personat e moshuar.
- Parandalimi nga sëmundjet kronike jo infektive.